



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. i raq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	06-1094/20
Data Datum Date	03.06.2020
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.06.2020, mori:

### V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. *AKK-DPKI-06/2838/19*, për zyrtarin e lartë z. Ragip Zogiani, Menaxher në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli: AKK-DPKI-06/2838/19, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ragip Zogiani, Menaxher në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, është zhvilluar procedura e paraparë konform Ligjit Nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtuftjeshëm: Agjencia), pasi ka identifikuar rastin për zyrtarin e lartë z. Ragip Zogiani, Menaxher në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, ka verifikuar informacionin ku i njëjti figuronte si person i autorizuar në biznesin privat Zyre e Teknologjisë Informatike "Din Don".

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht me shkresën zyrtare DPKI-06-2564/19, ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtuftjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-22564/19), rezulton se zyrtari i lartë z. Ragip Zogiani është person i autorizuar në biznesin në fjalë.





Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06/408/20, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, me kërkesë të tij është organizuar dhe mbajtur një takim brenda Agjencisë, ku zyrtari i lartë është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, ushtrimi i funksionit publik Menaxher në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, si dhe të qenurit njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, situatë e cila është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Zogiani, është pajtuar me gjetjet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka deklaruar se do të ndërmarr veprime konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë me datë 27.05.2020, Agjencia ka pranuar shkresë zyrtare me nr. protokolli: DPKI-06-408-1/20, me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Ragip Zogiani, ka bërë ndryshimet e nevojshme dhe se i njëjti nuk figuron më të jetë person i autorizuar në Ndërmarrjen Privatë Zyra e Teknologjisë Informatike “ Din Don ”.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Ragip Zogiani, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

